

Prof. dr. Hasan ÇIPURI

## ZBATIMI I NORMËS STANDARDE PËR PASTËRTINË E GJUHËS

*Gjuha jonë sa e mirë,  
sa e ëmbël, sa e gjerë,  
sa e lehtë, sa e lirë,  
sa e bukur, sa e vlerë!*

Dashuria për gjuhën amtare, për lulëzimin dhe zhvillimin e saj, ka qenë dhe mbetet një karakteristikë e përhershme dalluese e popullit tonë dhe forcë e madhe frymëzuese në jetën e tij shoqërore e kulturore, në luftën e tij për liri, pavarësi e përparim. Breza të tërë lëvruesh të gjuhës, arsimtarësh dhe atdhetarësh kanë punuar dhe janë përpjekur pareshtur për një gjuhë standarde kombëtare, kanë përkrahur prirjet për njësimin e gjuhës dhe kanë kundërshtuar e kapërcyer qëndrimet e ngushta e lokaliste në politikën gjuhësore. Dashuria për gjuhën ka ndihmuar gjatë Rilindjes, krahas faktorëve të tjerë historikë, për të ngritur vetëdijen dhe krenarinë kombëtare të popullit shqiptar.

Përparimi i gjuhës së sotme standarde shqipe është kurorëzimi i një procesi të gjatë e të ndërlikuar të kristalizimit të strukturës së saj në të gjitha hallkat: në fonetikë, në gramatikë dhe në fjalëformim.

Gjuha shqipe ka arritur sot në atë fazë zhvillimi që lejon të pohohet shkencërisht se populli shqiptar ka tashmë një gjuhë letrare standarde, që mbështetet gjerësisht në gjuhën e folur të popullit dhe përdoret si një mjet zhvillimi e përparimi në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore dhe pothuaj se nga të gjithë shqiptarët që flasin e shkruajnë shqip.

Për të mbështetur këtë ecuri të zhvillimit objektiv të gjuhës sonë standarde, ne kemi sot edhe një bazë të shëndoshë dhe të

gjerë studimore, shkencore e praktike, si: “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980) dhe “Fjalori i gjuhës shqipe”, grup autorësh (2006); “Fjalori i shqipes së sotme” dhe botimi i dytë i tij (2002); “Fjalori për pastërtinë e gjuhës shqipe”; Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe; “Fjalori i drejtshkrimit të gjuhës shqipe”; Gjuha letrare shqipe për të gjithë; revistat “Studime Filologjike”, “Gjuha jonë”, “Gjuha shqipe” (në Kosovë) etj.

E gjithë kjo letërsi shkencore, të gjitha institucionet tona kulturore kërkimore e arsimore, përfshirë edhe ato në Kosovë, Maqedoni, në Mal të Zi e në diasporë, krijojnë mundësi shumë të mëdha për përsosjen e mëtejshme të njohurive tona gjuhësore. “Fjalori shpjegues i gjuhës shqipe”, “Fjalori i drejtshkrimit të gjuhës shqipe” dhe “Fjalori për pastërtinë e gjuhës shqipe” janë pothuaj libra tryeze për çdo shqiptar që e dashuron gjuhën e tij amtare.

### **I. Problemet e sotme të gjuhës standarde**

Gjuha standarde shqipe ka kaluar një rrugë të gjatë e të ndërlikuar dhe ka arritur sot në shkallën e një gjuhe të pasur, të përpunuar, të standardizuar, të aftë për t’iu përgjigjur kërkesave të një shoqërie të zhvilluar demokratike.

Përparimet e mëdha që ka bërë, i detyrohen fuqisë krijuese të popullit tonë dhe punës së palodhur e të frytshme të sa e sa shkrimtarëve, lëvruesve dhe studiuesve të gjuhës sonë, mësuesve etj.

Themelet e gjuhës letrare të shqipes u vunë në Rilindje. Por ndihmesa me vlerë iu dhanë gjuhës së shkruar shqipe dhe zhvillimit të saj edhe më parë nga disa prej atyre që, në kushte shumë të vështira të pushtimit turk e të prapambetjes së shkaktuar prej tij, nuk nguruan të shkruanin shqip.

Një hov të madh i dha kësaj gjuhe, së pari, Rilindja. Çështjet gjuhësore në këtë periudhë dolën në plan të parë, duke qenë gjuha shqipe tipari dallues kryesor i kombit shqiptar, hallkë e bashkimit të tij, mjet i zhvillimit të kulturës kombëtare dhe i përparimit të tij. Përfundimi i këtyre përpjekjeve dhe i kësaj veprimtarie të gjerë, të vetëdijshme që krijimi i një gjuhe letrare kombëtare në dy variante mjaft të afuara.

Zhvillimi i gjuhës letrare shqipe pas Rilindjes e deri në ditët

tona bëri që ajo të fitojë aftësi dhe mundësi shprehjeje shumë të mëdha. Njëkohësisht, u shtjellua edhe një veprimtari sistematike për të kodifikuar gjithnjë e më shumë atë, për ta çuar gjithnjë e më tej afrimin e varianteve letrare gjer në kristalizimin e një gjuhe standarde kombëtare të vetme.

2. Nëse gjuha jonë standarde ka arritur sot shkallën e gjuhëve të zhvilluara e të kristalizuara, kjo nuk do të thotë që gjithçka është zgjidhur, s'ka më të meta, s'ka më asgjë për të bërë. Gjuha ndryshon, zhvillohet e përsoset gjithnjë. Jeta nxjerr pareshtur probleme të reja edhe këtu. Tani shtrohet detyra që të plotësohen, të përforcohen, të shpihen më tej përfundimet e arritura, të mënjanohen dobësitë që vërehen në praktikën e përditshme gjuhësore, të shtrohen mundësitë shprehëse të gjuhës standarde, të bëhet ajo edhe më e aftë për t'iu përgjigjur zhvillimit të shoqërisë sonë demokratike. Lufta për përsosjen e vijueshme të gjuhës standarde mbetet një kërkesë e përhershme. Këtë gjë e theksoi me forcë Konferenca kushtuar 30-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, që u mbajt më 11-12 nëntor 2002 në Tiranë.

Problemet e kulturës së gjuhës për pasurimin e kristalizimin e mëtejshëm të gjuhës standarde, për ruajtjen e individualitetit dhe origjinalitetit të gjuhës sonë kanë dalë në plan të parë. Çështjet këtu janë të shumta, por më kryesoret e më të ngutshmet prej tyre janë:

a) Përvetësimi nga të gjithë dhe zbatimi i plotë i normave të gjuhës standarde në të gjitha hallkat e sistemit gjuhësor.

b) Lufta këmbëngulëse e sistematike kundër gabimeve e shkeljeve të normave e veçorive të gjuhës shqipe në përgjithësi.

c) Ndjekja nga afër e dinamikës gjuhësore dhe vëzhgimi i vëmendshëm i proceseve të saj, rishikimi i herëpashershëm, në bazë të studimit, i kodifikimit të gjuhës standarde, për ta plotësuar e për ta përshtatur atë me zhvillimin që bën gjuha.

ç) Pasurimi i vijueshëm i gjuhës.

d) Përpunimi i pandërprerë i terminologjisë shkencore e teknike.

e) Ruajtja e origjinalitetit dhe individualitetit të gjuhës sonë, pastrimi i saj nga elementi i huaj i panevojshëm.

f) Ngritja e kulturës së përgjithshme gjuhësore, në radhë të parë nëpërmjet shkollës dhe mjeteve të medias.

3. Gjuha jonë standarde kombëtare ka zgjeruar në një shkallë të madhe dhe po i zgjeron gjithnjë e më shumë funksionet e saj, rrezatimin e saj, si në formën e shkruar, ashtu edhe në formën e folur. Ajo është gjuhë e të gjithë kombit shqiptar. Normat e saj janë bërë norma të përgjithshme të gjithë atyre që flasin shqip. Shkolla, letërsia artistike, botimet shkollore, shtypi, radiotelevizioni janë bërë mjete të fuqishme të përhapjes së tyre. Këto norma tashmë janë përpunuar në të gjitha hallkat e gjuhës. Po këtu ka ende shumë për të bërë.

Dobësi të ndjeshme paraqet veçanërisht forma e folur e gjuhës, megjithëse ka udhëzues drejtshkrimorë. Dobësi vërehen edhe në pikësim, që në gjuhën e shkruar ka një rol të rëndësishëm.

Krahas përpjekjeve që bëhen për mënjanimin e fjalëve, trajtave e ndërtimeve, që pajtohen me normat e gjuhës sonë standarde, del nevoja e luftës këmbëngulëse kundër gabimeve leksikore e gramatikore, kundër të gjitha atyre mënyrave të shprehjes që vijnë në kundërshtim me rregullsitë e veçoritë e gjuhës shqipe. Në të folur, po edhe në të shkruar, gjen fjalë të përdorura gabim, trajta të shtrembëruara, ndërtime të çala ose të gabuara, që nuk i njeh struktura sintaksore e gjuhës sonë.

4. Probleme qendrore në fazën e sotme të gjuhës standarde shqipe, të ndërlydhura ngushtë, janë pasurimi i saj me fjalë e mjete të reja gjuhësore dhe pastrimi nga elementi i huaj i panevojshëm.

Duhet thënë se në gjuhën tonë, në radhë të parë në gjuhën standarde, kanë hyrë e po hyjnë dhe po përdoren me shumicë fjalë, mjete gjuhësore e gjedhe (modele) të huaja, mjaft herë pa nevojë, sidomos nga politikanët. Depërtimi i elementit të huaj duhet t'i nënshtrohet, në çdo rast, një vëzhgimi të veçantë e kontrolli të vëmendshëm. Është e natyrshme që një gjuhë të pasurohet edhe me njësi leksikore e ndërtime të huaja. Por duhet bërë një trajtim i diferencuar i tyre, duke u nisur nga nevoja që ndihet për to dhe nga mundësia e pamundësia që ka gjuha për t'i zëvendësuar ato me elemente të thesarit të saj ose me krijime të reja.

Gjuha jonë është tani një gjuhë e pasur, me mundësi shprehëse të mëdha, që mund t'i përgjigjet kryesisht me pasurinë dhe mundësitë e veta nevojave të pasurimit të mëtejshëm të saj. Në gjuhën e gjallë popullore gjen me qindra e mijëra fjalë e

shprehje që, ashtu si përdoren ose me zgjerim kuptimi, e vlen të përgjithësohen e të hyjnë në gjuhën standarde. Ato i bëjnë të panevojshme ose i zëvendësojnë fjalët e huaja që përdoren në gjuhën letrare, ndonjëherë edhe termat, prandaj duhen gjurmuar, vënë në qarkullim e përdorur. Mbledhja sa më e plotë dhe e saktë e pasurisë leksikore e frazeologjike të gjuhës së gjallë qëndron gjithnjë si një detyrë atdhetare e shkencore, sidomos për arsimtarët që janë vazhdimisht pranë popullit.

5. Një vend qendror në kuadrin e pasurimit dhe pastrimit të gjuhës zë terminologjia shkencore e teknike. Termat nuk mbesin gjithnjë në rrethin e ngushtë të specialistëve përkatës. Shumë prej tyre kalojnë në leksikun e përgjithshëm, në ligjërimin e përgjithshëm.

6. Problem edhe më shqetësues sesa hyrja e fjalëve të huaja pa nevojë është ndikimi i dukshëm i gjuhëve të tjera në sintaksën e gjuhës sonë. Pasuria e mjeteve sintaksore është ndër treguesit kryesorë të shkallës së përpunimit të një gjuhe dhe është e lidhur në një masë të madhe me shkallën e zhvillimit kulturor të një populli. S'ka arsye të përdoren ndërtime të mbështetura në gjedhet e huaja, kur shqipja ka mënyrat përkatëse të shprehjes dhe kur të parat nuk sjellin gjë të re dhe të tilla ndërtime ndeshen, për fat të keq, dendur në gjuhën tonë standarde.

## **II. Pasurimi i gjuhës shqipe dhe pastrimi i saj nga fjalët e huaja të panevojshme**

A) *Pasurimi i gjuhës.* Një nga shfaqjet më të rëndësishme të zhvillimit të gjuhës sonë standarde është edhe pasurimi i saj me njësi të reja leksikore e frazeologjike dhe zgjerimi i rrethit të kuptimeve të fjalëve të njohura. Pasurimi i gjuhës lidhet me zhvillimet ekonomike, arsimore, shkencore e kulturore të vendit. Për të përballuar kërkesat e tyre për fjalë e terma e për të përmbushur nevojat kulturore të njeriut tonë në shoqërinë demokratike, gjuha standarde duhet të shtojë vazhdimisht fondin e fjalëve që janë në qarkullim.

Pasurimi i gjuhës është një proces objektiv, që kryhet çdo ditë nga pjesëtarët e shoqërisë sonë demokratike, nga specialistë të degëve të ndryshme të shkencës e të prodhimit, nga arsimtarët, shkrimtarët etj., të cilët gjatë punës së tyre kanë nevojë për emërtime

të mjeteve e të proceseve të punës, për fjalë e shprehje që japin në mënyrë sa më të përpiktë nocionet dhe idetë, që shprehin më me forcë e ngjyra më të gjalla jetën e përditshme të popullit tonë, botën e tij shpirtërore e kulturore.

### **Cilat janë rrugët dhe burimet e pasurimit të gjuhës shqipe:**

1. Rruga kryesore e pasurimit të leksikut është formimi i fjalëve të reja me burimin e vetë gjuhës dhe sipas gjedheve prodhimtare të sistemit fjalëformues të shqipes ose me rrugën e shqipërimit të pjesëve përbërëse të fjalëve të huaja (kalkimit). Numri i fjalëve të reja, të formuara në të gjitha fushat e jetës e të dijes, është mjaft i madh, p.sh.: *domosdoshmëri, ideor, krijimtari, mbishtresë, mëngjesore, rastësi, dukuri, shkakësi, shpërbërje, vetëshërbim, vetëvendosje, përvojë, përkryej, vetjak, përmasë, përkim, parimor, përparësi, parimësi* etj.

Formimi i fjalëve të reja me anë prapashtesash, parashtesash, duke bashkuar dy tema fjalësh (fjalë të përbëra e kompozita) është një nga rrugët kryesore për pasurimin e leksikut të shqipes.

2. Përdorimi më i gjerë i fjalëve dhe i frazeologjive nga goja e popullit. Këto fjalë mund të shërbejnë shpeshherë edhe për të zëvendësuar fjalë të huaja. Fjalë të gurrës popullore janë, p.sh.: *birëse* (trapan), *endacak* (nomad), *gërryerje* (erozion), *kah-u* (sens), *mjedis* (ambient), *ngopje* (faturim), *pështjellë* (spirë), *rrethina* (periferi), *shterp* (steril), *tatëpjetë* (dekadencë), *trill* (kapriçio) etj.

3. Për pasurimin e gjuhës standarde mund të shfrytëzohen edhe fjalë të krijuara nga epoka të mëparshme dhe që, për arsye të ndryshme, nuk kanë hyrë në përdorim ose kanë mbetur në periferi të gjuhës, p.sh.: *nismë, nismëtar, (iniciativë, iniciator), ngrehinë (stabiliment), nxisëz (inkurajoj)* etj.

A) *Pastrimi i gjuhës*. Krahas punës për pasurimin e gjuhës duhet të punohet edhe për pastrimin e saj nga fjalët e huaja të panevojshme dhe nga ndërtimet sintaksore, që janë ndikime të gjuhëve të huaja dhe bien në kundërshtim me sintaksën e shqipes. Pastrimit të gjuhës nga fjalët e huaja i kanë kushtuar një kujdes të veçantë rilindësit. Ne epokën tonë, lufta për pastrimin e gjuhës është shprehje e atdhetarizmit të popullit tonë dhe ka për qëllim të forcojë karakterin kombëtar të gjuhës letrare shqipe dhe të kulturës sonë, që shprehet me anën e saj.

Puna për pastrimin e gjuhës duhet të mbështetet në disa kritere

shkencore objektive:

1. Nuk shtrohet çështja e zëvendësimit të fjalëve me burim të huaj, që kanë hyrë prej shekujsh në gjuhën shqipe dhe që njihen e përdoren nga i gjithë populli, si: *avlli, flamur, lajm, mëndafsh, oreks, pronë, stolis, i pastër, trëndafil, tipar* etj. (nga greqishtja); *faqe, furrë, këmbë, këngë, krijoj, krijesë, mjek, qytet, qepë, lepur, qen, kushëri, prind, prift* etj. (nga latinishtja); *çekiç, çudit, çudi, dobi, kovë, grabit, gostit, strehë, plaçkë, pushkë, zakon* etj. (nga gjuhët sllave); *çarçaf, çizme, daulle, fitil, dyshek, top, xhep* etj. (nga turqishtja); *bankë, barkë, fitoj, karrocë, kushton, paguaj, timon, rimorkio e rimorkiator* etj. (nga italishtja) etj.

2. Nuk shtrohet, gjithashtu, as çështja e zëvendësimit të fjalëve ndërkombëtare ose ndërkombëtarizmave. Si fjalë ndërkombëtare do të vështrohen ndërkaq ato që përdoren në shumicën e gjuhëve të botës (veçanërisht në gjuhët indoevropiane), p.sh.: *atom, kushtetutë, raketë, planet, oqean, satelit* etj. Nuk do të quhen ndërkombëtarizma fjalët që përdoren vetëm në gjuhët romane (italisht, frëngjisht etj). Për këto fjalë duhet të bëhen përpjekje që të zëvendësohen me fjalë shqipe, ashtu siç është vepruar, p.sh., për *nuklear, solucion*, të gjuhëve romane, që janë shqipëruar përkatësisht me *bërthamor e tretësirë* etj.; *brifing, implementim, kamping* të anglishtes, që janë zëvendësuar përkatësisht me *trajtesë e kumtesë, zbatim e realizim, fushim* etj. Megjithatë, edhe ndërkombëtarizmat, kur është e mundshme do të shqipërohen, si p.sh., *neutral e neutralitet* (që përdoren në frëngjisht, italisht, spanjisht, gjermanisht, anglisht, rusisht etj) janë zëvendësuar me sukses me *asnjanës e asnjanësi*.

3. Në pastrimin e gjuhës do të merren parasysh edhe vlerat stilistike që kanë fituar fjalët e huaja gjatë përdorimit të tyre në gjuhën shqipe. Pastrimi i gjuhës shqipe nuk duhet ta varfërojë fuqinë shprehëse të mjeteve të saj e as të rrafshojë stilet funksionale të gjuhës standarde. Për këtë arsye, do të përdoret fjala e huaj si mjet për të tipizuar personazhe të caktuara, për të dhënë më me vërtetësi mjedisin historik ku zhvillohet ngjarja e një vepre etj. P.sh., për një numër turqizmesh, si: *dylfek, surrat, qitap, zabit* etj. ose do të lejohet të përdoren edhe fjala shqip, edhe fjala e huaj, e para në leksikon e përgjithshëm dhe në letërsinë më të përgjithshme, e dyta në letërsinë e ngushtë speciale.

4. Kur nuk është e mundur që fjala e huaj të zëvendësohet në të

gjitha përdorimet, do të zëvendësohet në disa prej tyre, p.sh., *plan me rrafsh* (në geometri etj.), por plan i punës. Po kështu, kur nuk është e mundur të zëvendësohet krejt çerdhja e fjalëve të huaja të formuara nga një rrënjë, do të zëvendësohen disa prej tyre, p.sh.: *nacion, nacional – komb, kombëtar, por nacionalizëm, nationalist* etj. mbeten.

5. Do të synohet të shqipërohen gjerësisht elementet fjalëformuese me prejardhje nga gjuhët e huaja (kur ajo është e mundshme), p.sh.: *antigaz- kundërgaz, depolarizim-shpolarizim, intermolekular-ndërmolekular, kultural-kulturor, muzikal-muzikor, furrxhi-furrta* etj.

### **Cilat fjalë të huaja duhen zëvendësuar?**

Në radhë të parë, do të synohet të zëvendësohen fjalët e huaja që kanë hyrë pa kriter, kryesisht nga italishtja, para dhe gjatë viteve të pushtimit. Kundër këtyre fjalëve është luftuar edhe në të kaluarën dhe një pjesë është zëvendësuar, p.sh.: *eksperiencë-përvojë, influencë-ndikim, koordinim e koordinoj-bashkërendim e bashkërendoj, konfuzion-pëstjellim, komponent-përbërës, fokusohet-vatërzohet e përqendrohet, prioritet-përparësi, prioritar- parësor, prezencë-prani* etj. Me të njëjtin ritëm duhen zëvendësuar fjalët e huaja, që kanë hyrë pa kriter nga rusishtja dhe sidomos ato që depërtojnë në ditët e sotme nga anglishtja dhe, nëpërmjet saj, edhe nga gjuhët neolatine e gjermanishtja.

Së dyti, do të bëhen përpjekje për t'i zëvendësuar ose për t'u ngushtuar më tej përdorimin një numri fjalësh të leksikut të përgjithshëm me burim nga gjuhët sllave, greqishtja e turqishtja, si: *akoma, nikoqirllëk, vadit, godinë* etj.

Së treti, do të nxirren jashtë nga përdorimi letrar fjalët e huaja dialektore periferike (sllavizma, greqizma etj.), që hera-herës dalin edhe në letërsinë artistike, kur nuk shërbejnë për tipizimin e personazheve, si p.sh.: *mollois, kumbisem, okllai, kum, pjavicë, ulicë, nakatos* etj.

Burimet dhe rrugët kryesore për pastërtinë e gjuhës dhe për zëvendësimin e fjalëve të huaja janë këto:

1. Të shfrytëzohet gjerësisht pasuria e fjalëve dhe e frazeologjisë së gjuhës sonë:

a) duke përdorur fjalët shqipe popullore, krahinore e të rralla

për të zëvendësuar fjalët e huaja, p.sh.: *emnak* për *adash*, *brezare* për *tarracë*, *hulli* për *brazdë*, *kryqëzore* e *tërthore* për *traversë* etj.;

b) duke zgjeruar kuptimin e fjalëve shqipe, kur një gjë e tillë është e mundshme, si p.sh.: *zotim* për *angazhim*, *pajtim* për *abonim*, *kërkues* për *ekzigjent* etj.;

c) duke përdorur frazeologjizma a togje fjalësh të qëndrueshme për të zëvendësuar fjalët e huaja, p.sh.: *ngul këmbë* (*ngulmoj*) për *insistoj*, *lë pas dore* për *neglizhoj* etj.

2. Të krijohen fjalë të reja nga brumi i shqipes. Këto mund të jenë:

a) fjalë të krijuara sipas gjedheve të shqipes, p.sh.: *nismë* për *iniciativë*, *i përhershëm* për *permanent* etj.;

b) fjalë kalke (krijime sipas modelit të fjalës së huaj, po me brumin e shqipes), p.sh.: *ndërkombëtar* (*internacional*), *epërsi* (*superioritet*), *përpjesëtim* (*proporcion*), *përparësi* (*precedencë* a *prioritet*), *dytësor* (*sekondar*) etj.

3. Të rivlerësohet puna që është kryer për shqipërimin e fjalëve të huaja gjatë Rilindjes dhe në periudhën e Pavarësisë. Kështu p.sh. *miratoj* për *aprovoj*, *ballafaqim* për *konfrontim*, *përballem* për *konfrontohem*, *depërtim* e *ndërfutje* për *penetrim*, *shndërrim* për *transformim*, *përqendrim* për *koncentrim*, *qendrueshmëri* për *stabilitet*, *prodhueshmëri* për *produktivitet*, *veprimtari* për *aktivitet*, *parimor* për *principal*, *përkryerje* për *perfeksion* etj. .

### C) Në fushën e përpunimit të terminologjisë shkencore e teknike

Për shqipërimin e mëtejshëm dhe standardizimin e terminologjisë duhen pasur parasysh disa kritere themelore:

1. Të shfrytëzohen fjalët e gjuhës së përgjithshme, duke u dhënë kuptim të ngushtë special në sfera të caktuara të shkencës e teknikës. Me një rrugë të tillë janë krijuar, p.sh.: *grimcë* (fr. *particule*), *bërthamor* (*nucleaire*) etj. Me kuptime speciale po përdoren sot edhe fjalë, të tilla si: *bukë* (e furnelës elektrike), *lodhje* (e metaleve), *fole* (e fishekut) etj. Edhe fjala *xhep* përdoret sot me kuptim special në disa fusha, si në ndërtim (*xhep ajri*), në ushtri (*xhep zjarri*), në industrinë e naftës (*xhep nafte*), në mekanikë (*xhep rrethor*) etj.

3. Një përpjekje e veçantë duhet bërë për të shqipëruar sa më shumë terma që përdoren pa nevojë nga gjuhët e huaja. Te ne janë

zëvendësuar me terma shqip mjaft terma që dikur dukeshin si të paprekshëm, p.sh.: *rikumbim (rezonancë), rrymë (korrent), përthithje (absorbim), shtresim (stratifikim)* etj. Për zëvendësimin e fjalëve të huaja që kanë hyrë vend e pavend, mbetet shumë për të bërë. Fjalë të tilla me prejardhje të huaj, si: *smontabël, lavatriçe, separator, solvent, solucion* etj. i kanë barasvlerëset të qarta e të kuptueshme: *i çmontueshëm, makinë larëse (rrobalarëse), ndarës, tretës, tretësirë.*

Një trajtim të veçantë kërkojnë ata terma që quhen “ndërkombëtarizma”, domethënë ata terma që i takojmë në disa gjuhë. Një pjesë e mirë e këtyre nuk duhet të shqipërohen, por duhet t’i përshtaten strukturës së shqipes (p.sh. termat: *atom, orbitë, kibernetikë, lazer, televizion, piramidë, mikroorganizëm, mikrob, kompjuter, internet* etj.). Megjithatë, duhet shikuar mundësia e nocionit. Nuk duhet harruar se nën maskën e fjalëve ndërkombëtare depërtojnë italianizma e galicizma (qofshin nga brumi latin e grek), që i kanë barasvlerëset në gjuhën shqipe. Të kësaj natyre janë, p.sh. termat: *frekuencë, ekuilibër, fenomen, poligon, reaksion, autotropi, elementar, korrent, neutral* etj, që zëvendësohen fare mirë me: *denduri, baraspeshë, dukuri, shumëkëndësh, kundëroprim, vetushqim, fillestar, rrymë, asnjans* etj. Këtu duhet pasur parasysh që të ruhem nga shqipërimi mekanik i fjalëve. Pse, p.sh., fjala *reaksion* do të mbetet si term i politikës, termi *skolastik* nuk do të shqipërohet me *shkollar*, që ka një kuptim të veçantë në gjuhën tonë, e kështu me radhë.

### Literatura e shfrytëzuar:

1. E. Çabej, *Për pastrimin e gjuhës shqipe*, “Gjuha jonë”, 1, 1981.
2. A. Xhuvani, *Për pastrimin e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1960.
3. A. Kostallari, *Gjuha letrare shqipe dhe epoka jonë*, SF/, 1984
4. Revista “Gjuha jonë” 1/82, 2/83, 2/84, 4/84, 3/85.
5. Robert Shvarc, “Pasurimi” i Gjuhës shqipe në mediat, Gazeta “Shekulli”, datë 3.5.2002, fq. 18.
6. M. Elezi, *Gjuha shqipe dhe pushteti i duartrokitjeve*, “Gazeta 55”, 15.11.2002, fq. 10.
7. Migjen Kelmendi, *Letër e hapur opinionit tiranas*, Gazeta “Korrieri”, datë 13.11.2002, fq. 2.
8. P. Kabo, *Po kujtohem për gjuhën*, Gazeta “Shekulli”, datë 09.09.2002.